



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
VLORE

Nr. 432 (71018-01181-61-2014)Akti  
Date 07.10.2014

Nr. 432(61-2014-3148)Vendimi  
Date 15.10.2014

VENDIM  
"NË EMËR TË REPUBLIKËS "

Gjykata e Rrethit Gjyqësore Vlore e përbërë nga :

Skënder HALUCI -GJYQTAR

Asistuar nga\*sekretarja gjyqësore Eglantina Murati, sot më datë 15.10.2014 ne séance gjyqësore me dyer te hapura, përfundoi se shqyrtuari ceshtjen penale me nr. 432 Akti, qe i përket:

**KERKUESE:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlore, e përfaqësuar nga prokurore

**OBJEKTI:** Konfiskimin e mjeti lundrues tip gomone, sekuestruar me procesverbalin e datës 20.09.2014.

**BAZA LIGJORE** Nenet 23/3 dhe 24/3 I Ligjit Nr. 8663, date 18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT"

Gjykata, pasi shqyrtoi ceshtjen, administroi dhe shqyrtoi provat ne tërësi, dëgjoi prokurorinë ne konkluzionet përfundimtare qe kërkoi:

Prokuroria a Rrethit Gjyqësor Vlore e përfaqësuar nga Prokurorja [redacted] ne konkluzionet përfundimtare kërkoi:

- *Pranimin e kërkesës*
- *Konfiskimin e mjetit lundrues tip gomone, sekuestruar me procesverbalin e datës 20.09.2014.*

**VEREN**

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlore është paraqitur kërkesa per Konfiskimin e mjetit lundrues tip gomone, sekuestruar me procesverbalin e datës 20.09.2014.

Lidhur me këtë mjet, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlore, ka regjistruar procedimin penal Nr. 1756 te vitit 2014 per vepren penale te parashikuar nga neni 23/1 I Ligjit Nr. 8663, date

18.09.2000 "Per regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT".

Ne hetimin paraprak per këtë procedim penal ka rezultuar se me date 19.09.2014, ora 05.20, Policia ne rruge operative ka marre informacionin, ne Sektorin e Shërbimeve Operacionale dhe Hetimit te DRKM Vlore, se ne nje distance rreth dy milje nga grykëderdhja e lumit Vjose, afër fshatit Dellenje Novosele, nga grupi I patrullimit te policisë kufitare te cilët kishin dale per lundrim me mjetin BP-05 me detyre shërbimi operacional per patrullimi ne rajonin Vjose-Plazhi Seman-Levan është gjetur e braktisur dhe e fikur nje mjet lundrues tip gomone, e markes "Grupo Mare", me ngjyre te bardhe, me mbishkrim anash "PHOLA 18" ne krahët anësor te tij, me gjatësi 5.8 m dhe gjerësi 2.2 m, I pajisur me nje motor model "YAMAHA 115 HP" me ngjyre gri, me numër serie F1 00AETL1000333.

Gjate kontrollit te ushtruar ne këtë mjet lundrues nuk është gjetur asnjë dokument, mbajtja e te cilëve ne bordin e mjetit lundrues është e detyrueshme ne baze te urdhërimeve te nenit 10 te ligjit Nr. 8663, date 18.09.2000, "Per regjistrimin,klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT"

Nga oficeri I policisë gjyqësore është mbajtur procesverbali I konstatimit te shkeljes I datës 19.09.2014, ora 05.20, ne te cilin nder te tjera thuhet: *Konstatimin e mjetit lundrues tip Gomone, me ngjyre te bardhe,me me mbishkrim anash "PHOLAS 18" ne te dy krahët anësorë te tij, me gjatësi 5.8 m, me gjerësi 2.2 m, me nje motor model "YAMAHA 115 hp Four Strike, mjrt I cili është sekuestruar nga policia me procesverbalin "Mbi sekuestrimin e mjetit lundrues" te datës 20.09.2014.*

Ne këto kushte Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlore, bazuar ne nenin 23/3 dhe 24/3 I Ligjit Nr. 8663, date 18.09.2000 i ka kërkuar gjykatës Konfiskimin e mjetit lundrues tip Gomone, te sekuestruar me procesverbalin "Mbi sekuestrimin e mjetit lundrues" te datës 20.09.2014.

#### **Ligji i Zbatueshëm.**

Neni 12 I Ligjit Nr. 8663, date 18.09.2000, "Per regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT" përcakton se: *"Cilido qe zotëron ose mban me çfarëdo lloj titulli nje mjet lundrues ose pjese te tij duhet te beje deklarim me shkrim brenda njëzet e katër orëve nga marrja ne zotërim ose mbajtja, ne zyrën e policisë kufitare përgjegjëse per territorin duke shënuar gjeneralitetet dhe vendqëndrimin e tij, vendbanimin e përhershëm te mjetit dhe gjeneralitetet e pronarit apo bashkëpronarit".*

Ne nenin 23/1 te Ligjit Nr. 8663, date 18.09.2000, "Per regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT" përcaktohet se: *"Mosdeklarimi I zotërimit apo mbajtjes sipas nenit 12 te këtij Ligji përben kundravajtje penale dhe shoqërohet me konfiskimin e mjetit lundrues nga oficeri I policisë gjyqësore".*

Ne nenin 24/1 te Ligjit Nr. 8663, date 18.09.2000, "Per regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nen 20 NT", përcaktohet se: *"Mungesa e matrikullimit ose e regjistrimit sipas nenit te këtij ligji përben kundravajtje penale dhe dënohet me gjobe dhe shoqërohet konfiskim te mjetit lundrues".*

Kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bazohet në: Nenet 23/3 dhe 24/3 të Ligjit Nr. 8663, datë 18.09.2000, "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT"

*Aktet provuese mbi të cilat mbështet kërkesa e Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Vlorë, janë:*

- Urdhër për regjistrimin e procedimit penal, datë 22.09.2014;
- Informacion për referimin e veprës penale tek prokurori, datë 20.09.2014;
- Procesverbal për konstatimin e shkeljes, datë 19.09.2014, ora 05.20
- Raport shërbimi datë 19.09.2014, ora 11.00;;
- Procesverbal për kqyrjen dhe marrjen e provës material, (mjet lundrues) datë 20.09.2014, ora 14.00;
- Vendim për sekuestrimin e mjetit lundrues, datë 20.09.2014;
- Vendim për vlefësimin e e sekuestrimit, datë 22.09.2014;
- Procesverbal për dorëzimin dhe lënien në ruajtje të mjetit lundrues në piken e bllokimit, datë 20.09.2014;

*Si dhe të gjitha aktet e tjera të administruara në fashikullin e gjykimit.*

Në analizë të rrethanave të parashtrimit të kësaj kërkesë gjykata vlerëson se kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për: *Konfiskimin e mjetit lundrues tip Gomone, me ngjyre të bardhe, me mbishkrim anash "PHOLAS 18" në të dy krahët anësorë të tij, me gjatësi 5.8 m, me gjerësi 2.2 m, me një motor model "YAMAHA 115 hp Four Strike, mjrt I cili është sekuestruar nga policia me procesverbalin "Mbi sekuestrimin e mjetit lundrues" të datës 20.09.201, është e bazuar dhe si e tillë duhet të pranohet nga gjykata.*

#### PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 384 të K.Pr.Penale si dhe në Nenet 23/3 dhe 24/3 të Ligjit Nr. 8663, datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT"

#### VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konfiskimin e mjetit lundrues tip gomone, sekuestruar me procesverbalin "Mbi Sekuestrimin e Mjetit Lundrues" të datës 20.09.2014. Tip Gomone e markes Grupo Mare me ngjyre të bardhe, me mbishkrimin PHOLA 18.
3. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Shpenzimet proceduriale siç janë bere.
5. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 ditësh duke filluar ky afat nga e nesërtnja e shpalljes..

U shpall në Vlorë sot në datë 15.10.2014!


SEKRETARE  
Eglantina MURATI

GJYQËSAR  
Skënder HALUCI

  
Kancelare  


Vendimi mori formë të prerë  
pasi nuk u ankimua  
më dt. 27.10.2014  
Vlorë më dt. 28.10.2014

K/ sekretare



SHPENZIMET GJYQËSORE

Shpenzime kancelarie	200	Lekë
Shpenzime totale	200	Lekë

Sekretare  
Eglantina Murati

